



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1003/2 Prot.

Tiranë, më 10.10.2023

V E N D I M

Nr. 197, Datë 10.10.2023

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 166, datë 13.09.2023, e bërë nga shtetasi T.B kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “orientimit seksual”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Unë ankuesi i përkas komunitetit LGBTI¹ dhe jam i papunë. Jam i sëmurë me prapambetje mendore, kam probleme hormonale dhe kam recetë nga mjeku për të marrë ilaçe për hormone (Nebito). Kam nevojë të bëj një operacion për mbyllje të kanalit të spermogramës dhe kushton 35.000 mijë lekë. Unë nuk kam të paguaj dhe mjekët nuk marrin përsipër për të bërë operacionin pa lekë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi që bëjë të mundur kryerjen e operacionit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje

¹ Referuar Vërtetimit datë 20.06.2019 të lëshuar nga Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT.

me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në aktet e vendosura në dispozicion, rezulton se ankuesi, nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion me të cilin të vërtetojë se ka kryer vizitë mjekësore tek mjeku i familjes dhe të jetë pajisur me recetë mjekësore apo që të ketë bërë vizitë mjekësore tek mjeku specialist dhe ta kenë rekomanduar për të kryer ndërhyrje kirurgjikale.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në neni 33/4, gërma “ç”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara e pretendimeve të subjektit ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së paraqitur nga T.B, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA